



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 65

Tiranë – E hënë, 13 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr.14, datë 11.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar..... 3617
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.284, datë 10.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”..... 3618
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.287, datë 10.4.2020	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit të rristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH, sh.a.-së dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar, ratifikuar me ligjin nr.9045, datë 3.4.2003..... 3618
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.288, datë 10.4.2020	Për përcaktimin e masës dhe të procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile..... 3629
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.289, datë 11.4.2020	Për lirim nga detyra të prefektit të qarkut të Shkodrës..... 3632
Vendim i Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile nr.6, datë 9.4.2020	Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike..... 3633

Vendim i Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile nr.7, datë 9.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”.....	3633
Vendim i Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile nr.8, datë 11.4.2020	Për caktimin e të deleguarit të Komitetit Ndërmator të Emergencave Civile, për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore, në qarkun e Shkodrës.....	3634



AKT NORMATIV
Nr. 14, datë 11.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË AKTIN NORMATIV NR.3,
DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E
MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Paragrafi i tretë, i pikës 20, të nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Të gjithë qiramarrësit, persona fizikë/juridikë, me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, pavarësisht nëse e kanë të lejuar apo të ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.”.

Neni 2

Pas nenit 5/1 shtohet neni 5/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/2

Kontratat publike për furnizimin me mallra
emergjente dhe bazike nga biznesi i
përpunimit aktiv

Autoritetet kontraktore, me qëllim përmbushjen e nevojave për mallra/shërbime të nevojshme, për

një kohë lëvrimi shumë të shkurtër, ose për raste veçanërisht të leverdisshme, që paraqiten në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim më të ulët se çmimet normale të tregut, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, për përballimin e nevojave emergjente, kryejnë procedura prokurimi me negocium, pa shpallje papaprake të njoftimit dhe lidhin kontratat e furnizimit për këto mallra me operatorët ekonomikë të referuar si “biznesi i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të Kodit Doganor.

Bizneset e përpunimit aktiv, sipas parashikimit në këtë nen, që prodhojnë mallra ose ofrojnë shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19, pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ, nëse kanë mallra/shërbime të leverdisshme, në kuptim të këtij neni, shprehin disponibilitetin e tyre pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (ABP).

Autoritetet kontraktore do të negociojnë vetëm me operatorët e listuar në ABP, sipas mallrave/shërbimeve që duan të prokurojnë. ABP-ja ka detyrimin të përditësojë çdo ditë listën e bizneseve që shprehin disponibilitetin e tyre.

Nëse nevoja nuk mund të plotësohet nga këta operatorë, autoritetet kontraktore mund t'i drejtohen operatorëve të tjerë ekonomikë për përmbushjen e kërkesës për këto mallra, sipas procedurës me negocium, pa shpallje papaprake të njoftimit. Autoritetet kontraktore që do të prokurojnë mallra ose shërbime, sipas këtij neni, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përfshihen nga rregulli i përcaktuar në këtë nen të gjitha procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 284, datë 10.4.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.254, DATË 27.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS
SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT
NË SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË
ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË
LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE E TË
PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA
PAPUNËSIA GJATË PERIUdhËS SË
FATKEQËSISË NATYRORE, TË
SHPALLUR SI PASOJË E COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 2 dhe 3, të kreut II, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vetëpunësuarit/punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se një listëpagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrenguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale.

Në rastin kur vetëm një prej aktiviteteve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se në një listëpagesë, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.

3. Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, sipas kategorizimit të mëposhtëm:

a) Personat fizikë të vetëpunësuar;

b) Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;

c) Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;

ç) Të punësuarit në personat juridikë.”.

b) Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Nuk përfitojnë ndihmë financiare individët e vetëpunësuar/punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë.”.

c) Në pikën 1, të kreut V, vlera “... 5 850 000 000 (pesë miliardë e tetëqind e pesëdhjetë milionë) lekë ...” ndryshohet dhe bëhet “... 6 416 000 000 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 287, datë 10.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH, TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
ITALISË, PËR REALIZIMIN E
PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT
TEKNIK DHE MENAXHUES TË KESH,
SH.A.-SË DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT
ELEKTRIK SHQIPTAR, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR.9045, DATË 3.4.2003**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit



të ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH, sh.a.-së dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar, ratifikuar me ligjin nr.9045, datë 3.4.2003, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ambasada e Italisë
Tiranë

Tiranë, më 13.08. 2019
Nr. Prot. 3083

NOTË VERBALE

Ambasada e Italisë në Tiranë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin t'i referohet Notës Verbale nr. 6804 datë 17.07.2019 me të cilën Ministria juaj, në emër të Qeverisë shqiptare, ka propozuar ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për realizimin e "Programit të ristrukturimit teknik dhe menaxherial te KESH dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar", lidhur në Tiranë më 13 shkurt 2003:

1. Për palën italiane, duke marrë parasysh Ligjin italian nr. 125 të vitit 2014:

- "Ministria e Punëve të Jashtme" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar";

- Akronimi "MAE" zëvendësohet në të gjitha nenet me "MAECI";

- Çdo referencë për UTC është eliminuar në të gjitha nenet;

- "Mediocredito Centrale" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Arka e Depozitave dhe Huave";

- Akronimi "MCC" zëvendësohet në të gjitha nenet me "CDP".

2. Për palën shqiptare, duke patur parasysh Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 504 datë 13.09.2017 dhe Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 157 datë 12.02.2018:

"Ministria e Industrisë dhe Energjisë" zëvendësohet në të gjitha nenet me "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë";

- "KESH" zëvendësohet në të gjitha nenet me "OSHEE sh.a"

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e
Republikës së Shqipërisë
TIRANË

3. Në nenin 7 (Mënyra e përfitimit të Shërbimeve, Furnizimeve dhe Punimeve) fjalët "e përfshira në MANUALIN E PROCEDURAVE (miratuar nga Komisioni Evropian më 10 nëntor 1999) në lidhje me: "Tender për Shërbime, Furnizime dhe Punime në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta" si dhe siç përcaktohet në Shtojcën 5", zëvendësohen me fjalët "të përfshira në Shtojcën 5"

4. Shtojcat 2 (Kushtet e Realizimit), 3 (Burimet financiare) dhe 5 (Tender për Shërbime, Furnizime dhe Punime (kushte të veçanta), zëvendësohen nga Shtojcat e reja 2, 3 dhe 5 bashkëlidhur këtij Shkëmbimi Notash Verbale.

5. Kohëzgjatja e Marrëveshjes shtrihet deri në fund të aktivitetit dhe shlyerjes së kredisë.

Kuptohet që Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, lidhur në Tiranë më 13 shkurt 2003, do të interpretohet, zbatohet dhe integrohet në



përputhje me kuadrin legjislativ dhe rregullues aktual italian për çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim.

Për këtë qëllim, Ambasada ka nderin të komunikojë se Qeveria e Republikës së Italisë pranon propozimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe është dakort që Nota e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe kjo përgjigje, të përbëjnë një Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë amenduese e Marrëveshjes për realizimin e “Programit të rristurimit teknik dhe menaxhial të KESH dhe fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar”, lidhur në Tiranë më 13 shkurt 2003, që do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët do të kenë komunikuar zyrtarisht kryerjen e procedurave të brendshme të ratifikimit.

Ambasada e Italisë përfiton nga rasti për t’i përsëritur Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë, ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

SHTOJCA 2

KUSHTET E REALIZIMIT

Duke pasur parasysh që OSHEE tashmë ka miratuar Statutin e ri, për realizimin e këtij Programi, Qeveria Shqiptare merr përsipër të zbatojë:

1. Parakushtet e treguara në tabelën më poshtë;
2. Kushtet përkatëse të treguara në po të njëjtën tabelë;
3. Të miratohet, sipas afateve të treguar në tabelë, masat e domosdoshme për të arritur rezultatet.

		Parakushtet
		Për çdo tender, OSHEE duhet të garantojë burimet financiare të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve lokale (punime civile, taksa dhe detyrime doganore). Shumat në ngarkim të OSHEE duhet të futen në buxhetin përkatës vjetor, përpara shpalljes së secilit tender.
	Logjika e ndërhyrjes	Kushtet
Objekti specifik	Autonomia progresive e menaxhimit të OSHEE-së sipas kriterëve moderne (në një sistem efikas rajonal).	1. Zbatimi i planit të riorganizimit të OSHEE (unbundling) e miratuar tashmë që më datë 08.04.02 (Power Sector Policy Statement) 2. Rregullimi progresiv i tarifave të energjisë elektrike me kostot operative dhe investuese të OSHEE-së.
Rezultate e pritshme	1. Përmirësimi gradual i krizës financiare të OSHEE 2. Shërbim elektrik më efikas dhe i besueshëm	1. Angazhimi i qeverisë për të paguar borxhet (2003 + 2005) dhe faturat aktuale të konsumatorëve buxhetorë dhe jo-buxhetorë (duke filluar nga viti 2003). 2. Programimi i planit të rritjes së tarifave. 3. Rimbursimi i TVSH-së për OSHEE në përputhje me parashikimet e legjislativitetit shqiptar. 4. Legalizimi i shërbimeve (brenda vitit 2005) dhe pagesa e rregullt e faturave (policia elektrike).



Aktivitete	Logjika e ndërhyrjes	Kushtet
	1. Shërbimet inxhinierike për projektimin e ndërhyrjeve, duke përfshirë Qendrën e re të Dërgesave.	Miratimi i Planit të Prokurimit. Identifikimi i vendit ku do të vendoset selia e re.
	2. Shërbimet e asistencës në menaxhimin e lartë dhe në divizionet e OSHEE (gjenerimi, transmetimi, shpërndarja dhe financa).	Identifikimi i roleve kyç para fillimit të zbatimit të kontratës.
	3. Blerja e automjeteve	
	4. Përfundimi i sistemit të faturimit dhe arkëtimit të faturave	Identifikimi i organeve përgjegjëse për dërgimin dhe mbledhjen e faturave
	5. Blerja e sahateve dhe instalimi i tyre në zonat e paracaktuara	Angazhimi i OSHEE për të respektuar kohëzgjatjen e instalimit
	6. Blerja e automjeteve dhe pajisjeve për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes	
	7. Nënstacioni Tërana 2	Vënia në dispozicion e terrenit para shpalljes së tenderit
	8. Përfundimi i nënstationit Kashar	
	9. Punët dhe Shërbimet Inxhinierike për Rehabilitimin e Rrjeteve Elektrike të Himarës dhe Dhërmiut	Vënia në dispozicion e terrenit para shpalljes së tenderit
	10. Punët dhe Shërbimet Inxhinierike për Rehabilitimin e Rrjeteve Elektrike të Orikumit	Vënia në dispozicion e terrenit para shpalljes së tenderit
	11. Rrjeti i shpërndarjes së Durrësit	Përfundimi i projekteve ekzekutive dhe rregullimi i procedurave për kërkimin e lejeve të kalimit, para caktimit të kontratës
	12. Mbështetje dhe shërbime ndihmëse për PMU-në për menaxhimin e Programit (DONO)	Krijimi i PMU
	13. Monitorimi i Programit nga ana e DGCS (DONO)	Fillimi i aktiviteteve

Të dyja palët angazhohen që së bashku të përcaktojnë dhe zbatojnë të gjitha masat që do të konsiderohen të nevojshme të merren nëse, gjatë zbatimit të programit verifikohet pamundësia për të përmbushur kushtet e lartpërmendura.

BURIME FINANCIARE

Me qëllim zbatimin e këtij Programi, të dy Palët angazhohen që të vënë në dispozicion burimet financiare të paraqitura në tabelën në vijim:

Aktiviteti	Përshkrimi	Kredi ndihme (EURO)	Dhuratë (EURO)	Financime lokale (EURO)	TOTALI (EURO)
Shërbime inxhinierike për projektimin dhe për asistencën me natyrë teknike për OSHEE	Kontratë për shërbime (kompani konsulence)	1.465.353,16	0	0	1.465.353,16
Projektimi i Qendrës së re së Dërgesave	Kontratë për shërbime (kompani konsulence)	555.191,17	0	0	555.191,17
Shërbime ndihmëse menaxheriale për drejtuesit e lartë të OSHEE	Kontratë shërbimesh (Public Utility)	4.166.151,45	0	0	4.166.151,45
Punime dhe Shërbime Inxhinierike për Rehabilitimin e Rrjetit Elektrik të Himarës dhe Dhërmiut	Kontratë shërbimesh dhe punimesh	8.710.000,00		1.678.484,93	10.388.484,93
Punime dhe Shërbime Inxhinierike për Rehabilitimin e Rrjeteve Elektrike të Orikumit	Kontratë shërbimesh dhe punimesh	7.973.498,50		1.678.484,93	9.651.983,43



Blerja e automjeteve për lëvizjen e personelit të OSHEE-s	Kontratë furnizimi	769.727,35	0	0	769.727,35
Përfundimi i sistemit të faturimit dhe arkëtimit të faturave	Kontratë furnizimi	702.400,00	0	0	702.400,00
Blerja dhe montimi i sahateve	Kontratë furnizimi dhe instalimi në ngarkim të OSHEE-së)	4.948.500,00	0	2.711.398,72	7.659.898,72
Blerja e automjeteve dhe pajisjeve për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes	Kontratë furnizimi	1.168.452,00	0	0	1.168.452,00
Nënstacioni Tirana 2	Kontratë me çelësa në dorë	8.148.883,02		516.456,90	8.665.339,92
Ndërtimi i linjës 400 KV Elbasan 2 Tirana2	Kontrata punimesh dhe furnizimesh	2.919.884,38	0	0	2.919.884,38
Asistencë për PMU dhe Monitorimi i programit	Misioni DGCS – Fond Ekspertësh	0	817.293,04	0	817.293,04
Mbështetje për PMU	Pagesat e personelit, pajisjet e zyrës dhe shpenzimet e zakonshme	0	162.167,47	0	162.167,47
Detyrime doganore	Taksa lokale	0	0	3.227.855,62	3.227.855,62
	TOTALI	41.528.041,03	979.460,51	9.812.681,08	52.320.182,62

Kontributi i Qeverisë italiane do të jetë :

-Kredi ndihmëse 41.528.041,03 EURO;

-Dhuratë 979.460,51 EURO;

-Totali 42.507.501,54 EURO.

Kontributi i OSHEE -s do të jetë prej: 9.812.581,08 EURO

Kostoja e përgjithshme e nismës rezulton kështu e barabartë me 52.320.182,62 Euro

SHTOJCA 5

KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET THEMELORE PËR LIDHJEN DHE ZBATIMIN E KONTRATAVE

Kjo shtojcë përcakton klauzolat etike dhe parimet themelore në të cilat bazohet përzgjedhja e kontraktuesit, lidhja dhe zbatimi i kontratave të furnizimit, shërbimet dhe punimet e parashikuara nga Marrëveshja. Për çështjet që nuk përfshihen në këtë shtojcë, zbatohet legjislacioni i referencës të përcaktuar nga Marrëveshja.

1. KËRKESAT E KONTRAKTUESIT

1.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshje, procedurat e përzgjedhjes së kontraktuesit janë të hapura për operatorët ekonomikë të Bashkimit Evropian, për ata të parashikuar në nenin 25 të Direktivës 2014/24/BE dhe atyre që zotërojnë kërkesat dhe autorizimet e parashikuara nga legjislacioni lokal.

1.2 Autoriteti kontraktor mund t'u vendosë operatorëve ekonomikë një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme të pjesëmarrjes, me kusht që ato t'i përmbahen dhe të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

1.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë kërkesa për të garantuar që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të ekzekutuar Kontratën. Për këtë qëllim Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të përcaktuar, duke përfshirë një xhiro të përcaktuar minimale në sektorin e aktivitetit objekt të kontratës, me kusht që të mos kalojë dyfishin e vlerës së përcaktuar në kontratë, përveç rrethanave të justifikuara siç duhet, në lidhje me rreziqet specifike që lidhen me natyrën e punimeve, shërbimeve ose furnizimeve. Për kontratat e ndarë në lote, ky paragraf zbatohet për secilin lot. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor mund të përcaktojë xhiron minimale vjetore që operatorët



ekonomikë duhet të kenë, duke iu referuar grupit të loteve në rast se ofertuesit të suksesshëm i janë dhënë për të ekzekutuar disa lote njëkohësisht.

1.2.2 Kapaciteti Teknik dhe profesional: Autoriteti Kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të kenë burimet njerëzore dhe teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me një standard të përshtatshëm të cilësisë. Autoriteti Kontraktor, mund të kërkojë, në veçanti, që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm të përvojës të provuar me referenca të përshtatshme në lidhje me kontratat e ekzekutuara më parë. Në procedurat e tenderit për furnizime që kërkojnë punimet e vënies në punë ose instalimeve, shërbimet ose punimet, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të kryer shërbime të tilla mund të vlerësohet duke iu referuar kompetencës, efikasitetit, përvojës dhe besueshmërisë së tyre.

1.2.3 Kualifikimi në ushtrimin e aktivitetit profesional; Autoritetet Kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një regjister profesional ose tregtar të mbajtur në shtetin në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar.

1.3. Dokumentet e tenderit tregojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele minimale të kapacitetit dhe mjete të përshtatshme të provës.

1.4. Nëse një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për sa i takon kritereve që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, Autoriteti Kontraktor, kërkon që operatori ekonomik dhe subjektet e përmendura më lart të jenë plotësisht të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës.

1.5 Në rastin e kontratave të punimeve, kontratave të shërbimit ose operacioneve të vënies në punë ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, Autoriteti përkatës tregon në dokumentet e tenderit detyrat thelbësore që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga vetë ofertuesi ose, në rastin e një oferte të paraqitur nga një grup operatorësh ekonomikë, nga një pjesëmarrës në këtë grup operatorësh.

1.6. Përfshihen nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe nuk mund të fitojnë apo lidhin kontratat përkatëse, konkurrentët të cilët;

1.6.1 Janë të dënuar me një dënim të formës së prerë, për një nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet në nenin 57, paragrafi 1, i Direktivës 2014/24/BE: pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, vepra terroriste, ose vepra penale që lidhen me veprimtari terroriste, pastrim i produkteve të veprimtarisë kriminale ose financime për terrorizmin, puna e të miturve ose të tjera forma të trafikimit të qenieve njerëzore;

1.6.2 Janë të dënuar me një dënim të formës së prerë, për çdo krim tjetër nga ku rrjedh, si dënim plotësues, pamundësia për të kontraktuar me administratën publike të një prej Palëve të kësaj marrëveshjeje ose të shtetit në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.3 Kanë kryer shkelje të rënda, të konstatuara përfundimisht, në lidhje me detyrimet për pagimin e taksave ose kontributet e sigurimeve shoqërore, nëse kjo është vendosur me një vendim gjyqësor ose administrativ që ka efekt të formës së prerë dhe detyruet në një nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin ata janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.4 Kanë kryer shkelje të rënda, të konstatuara përfundimisht, në lidhje me detyrimet mbi shëndetin dhe sigurinë në punë, të drejtën mjedisore, sociale dhe të punës në një nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin janë vendosur ose inkorporuar;

1.6.5 Gjenden në një nga situatat e mëposhtme ose i nënshtrohen një procedure për konstatimin e falimentimit, likuidimit të detyrueshëm administrativ, marrëveshjes me kreditorët, pranimit të marrëveshjes me vazhdimësi të biznesit ose ndodhen në çdolloj situatë të ngjashme;

1.6.6 Janë fajtorë për krime të rënda profesionale, që Autoriteti Kontraktor është në gjendje të provojë me mjetet e duhura, të tilla që e bëjnë të dyshimtë integritetin ose profesionalizmin e tyre;

1.6.7 Janë ata, apo subjektet që i përkasin të njëjtit grup juridik, anëtarë të bashkimeve të operatorëve, shoqërive të përkohshme dhe nënkontraktore, në konflikt interesi lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procesin e tenderimit, për shkak se i kanë siguruar konsulencë administratës publike që ka fuqinë për të dhënë kontrata publike ose organit publik që ka shpallur tenderin ose kanë marrë pjesë në përgatitjen e procedurës së prokurimit.



1.6.8 Kanë lëshuar për autoritetin e njërit prej Shteteve Palë në këtë Marrëveshje, deklarata të rreme në procedurën në proces dhe në dhënien e nënkontratave në sigurimin e informacionit të kërkuar për të verifikuar mungesën e arsyeve për përjashtimin ose respektimin e kriterëve të përzgjedhjes, ose, kanë fshehur këto informacione ose janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Kombëtar Kundër Korrupsionit të Republikës Italiane për paraqitjen e deklaratave të rreme ose dokumentacionit të rremë me qëllim lëshimin e dëshmisë së kualifikimit.

1.6.9 Janë prekur nga një shkak i konfiskimit, pezullimit ose ndalimit të parashikuar nga legjislacioni i të dy Palëve kontraktuese në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit;

1.6.10 I janë nënshtruar, për kundërvajtje administrative që rrjedhin nga vepra penale të verifikuara me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërin prej Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin janë vendosur ose inkorporuar, një sanksioni që përfshin ndalimin e kontraktimit me administratën publike;

1.6.11 Kanë shkelur ndalimin e marrjes së besueshmërisë parashikuar në legjislacionin e njëres prej Palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e marrësve si persona ndërmjetës në shoqëritë e besimit.

1.6.12 Nuk janë në përputhje me rregullat që disiplinojnë të drejtën për punë të personave me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të vendit të cilit i përket Autoriteti Kontraktor;

1.6.13 Ndodhen në raport me një tjetër pjesëmarrës në të njëjtën procedurë besimi, në situata kontrolli ose në çdo lloj marrëdhënieje tjetër, edhe faktike, nëse situata e kontrollit ose marrëdhënia bën që ofertat t'i atribuohen një qendër të vetme vendimmarrëse;

1.6.14 Kanë lidhur kontrata punësimi ose vetëpunësimi dhe gjithsesi i kanë caktuar detyra ish-punonjësve të Autoritetit Kontraktor të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e tyre të punës prej më pak se tre vitesh dhe që në tre vitet e fundit të shërbimit kanë ushtruar fuqi autoritare ose negociuese për llogari të këtij Autoritet Kontraktor kundrejt të njëjtit operator ekonomik.

1.7 Një operator ekonomik duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit edhe në rastin kur arsyet për përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 1.6 kanë të bëjnë me një

anëtar të këshillit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të këtij operatori ekonomik ose një person, që ka të drejta të tilla, përfaqësimi, vendimi ose kontrolli.

2. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË KONTRAKTUESIT

2.1 Dhënia dhe ekzekutimi i kontratave të punëve, shërbimeve, furnizimeve dhe koncesioneve, garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe zhvillohen në përputhje me parimet ekonomike, efektivitetit, kohës dhe korrektësisë. Në dhënien e kontratave dhe koncesioneve, Autoritetet Kontraktuese, gjithashtu respektojnë parimet e konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe publicitetit. Parimi ekonomik mund t'u nënshtrohet, brenda kufijve të lejuara shprehimisht nga ligjet në fuqi, kriterëve të parashikuara në njoftim, të frymëzuara nga nevojat sociale, si dhe mbrojtja e shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, edhe nga pikëpamja energjetike.

2.2 Dhënia e procedurës së tenderit ose koncesionit nuk mund të ketë si qëllim kufizimin artificialisht të konkurrencës, me qëllim për të favorizuar apo disavantazhuar padrejtësisht disa operatorë ekonomikë ose punime, furnizime dhe shërbime të caktuara.

2.3 Kriteret për pjesëmarrje në tender duhet të jenë të tilla që të mos përjashtojnë mikro-ndërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

2.4 Dokumentacioni i tenderit specifikon fondin limit të kontratës që do të jepet. Ofertat për vlera më të larta përjashtohen automatikisht.

2.5 Procedura e përzgjedhjes së kontraktuesit anulohet nëse janë paraqitur më pak se tre kandidatura/oferta të pranueshme. Nëse kushtet objektive të tregut e bëjnë shumë të vështirë paraqitjen e tri ofertave të përshtatshme, njoftimi i tenderit mund të lejojë shpalljen e fituesit edhe në prani të një ose dy ofertave të vlefshme.

2.6 Secili konkurrent nuk mund të paraqesë më shumë se një ofertë. Me paraqitjen e ofertës në një tender, konkurrentët deklarojnë që nuk kanë konflikt të mundshëm interesi dhe se nuk kanë asnjë lidhje të veçantë me konkurrentët e tjerë apo palët e tjera në pozita të ndryshme të përfshira në projekt.

2.7 Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentacionin e tenderit, variantet e ofertës nuk



janë të autorizuar. Variantet janë të lidhura me objektin e tenderit.

2.8 Për pjesëmarrje në procedurat e përzgjedhjes që i nënshtrohen autorizimit të AICS (Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim), Autoriteti Kontraktor kërkon që ofertuesit të ofrojnë një sigurim të garancisë në një shumë të barabartë me 2% të fondit limit të tenderit. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurime, ato duhet të parashikojnë heqjen dorë nga përfitimi i detyrimit paraprak të pagesës së debitorit kryesor dhe të jenë operative me kërkesë të thjeshtë me shkrim të Autoritetit kontraktues. Sigurimi i garancisë së kontratës është i zbatueshëm në rast të mosnënshkrimit të kontratës që i atribuohet kontraktuesit.

3.ZBATIMI I KONTRATAVE

3.1 Ekzekutimi i kontratave për kontratat që do të lidhen në vijim të një procedure përzgjedhjeje që i nënshtrohet autorizimit të AICS, garantohej me një garancitë kontratës prej 10% të shumës së kontratës. Sigurimet e garancive mund të jenë bankare ose sigurime, ato duhet të parashikojnë heqjen dorë nga përfitimi i detyrimit paraprak të pagesës së debitorit kryesor dhe të jenë operative me kërkesë të thjeshtë me shkrim të Autoritetit kontraktues. Garancitë e zbatimit të kontratës duhet të përfshijnë, në dokumentacionin e tenderit, zbatimin në rast mashtrimi ose mospërbushje të kontratës nga zbatuesi. Garancitë e zbatimit çlirohen në mënyrë progresive në përputhje me ecurinë e ekzekutimit dhe në çdo rast brenda kufirit maksimal prej 80% të shumës së garantuar. Pjesa e mbetur prej 20% çlirohet pas verifikimit të zbatimit të rregullt.

3.2 Kontratat mund të modifikohen gjatë zbatimit me miratimin paraprak të AICS dhe brenda kufijve të parashikuar në nenin 72 të Direktivës 2014/24/BE. Shuma e ndryshimeve, gjithsesi nuk mund të tejkalojë burimet e përgjithshme financiare të parashikuara për zbatimin e Marrëveshjes. Miratimi i ndryshimeve mund të refuzohet në qoftë ato e bëjnë të pamundur ose jashtëzakonisht të pamundur ekzekutimin e të gjithë komponentëve të nismës së parashikuar nga Marrëveshja.

Kontraktuesit nuk kanë të drejtë për ndonjë pagesë ose rimbursim për ndryshimet e bëra pa autorizimin paraprak nga AICS. Me kërkesë të AICS ose nga Autoriteti kontraktues, kontraktuesi

siguron, me shpenzimet e veta, që ta rikthejë atë si në gjendjen e mëparshme.

3.3 Autoriteti Kontraktor, nëse gjatë zbatimit është e nevojshme të rriten ose zvogëlohen shërbimet deri në arritjen e një të pestës së shumës së kontratës, mund t'i imponojë kontraktuesit ekzekutimin me të njëjtat kushte të parashikuara në kontratën fillestare. Në këtë rast kontraktuesi nuk mund ta zgjidhë kontratën

3.4 Kontratat nuk mund t'i jepen palëve të treta, gjë e cila përndryshe shpie në zgjidhjen ligjore të kontratës. Dhënia është e pranueshme, me miratim paraprak të AICS, vetëm nëse kontraktuesit fillestar i përfshihet, për shkak vdekjeje apo pas rristurimit të shoqërive, duke përfshirë zëvendësimin, shkërrjen, bashkimin, blerjen dhe paaftësinë paguese, një operator tjetër ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes cilësore të përcaktuara fillimisht, me kusht që të mos implikojë ndryshime të tjera thelbësore në kontratë dhe të mos ketë si qëllim shmangien e zbatimit të kësaj shtojce.

3.5 Kohëzgjatja e kontratës mund të modifikohet ekskluzivisht për kontratat në proces zbatimi, nëse një mundësi zgjatjeje është parashikuar në dokumentet e tenderit. Në këtë rast kontraktuesi është i detyruar të kryejë shërbimet e ofruara në kontratë me çmime, afate dhe kushte të njëjta ose më të favorshme për Autoritetin Kontraktor.

3.6 Pa cenuar respektimin e detyrimeve të gjurmueshmërisë sipas paragrafit 3.9, dhëniet e kredive nga vlera e tenderit, koncesionit, konkursit të projektimit, janë efektive dhe të kundërshtueshme ndaj Qeverisë italiane vetëm me miratimin paraprak të AICS. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor, të cilit i është njoftuar dhënia, duhet të ruajë të drejtën për t'i kundërshtuar dhënësit të gjitha përjashtimet e kundërshtueshme ndaj dhënësit në bazë të kontratës lidhur me punët, shërbimet, furnizimet, planifikimin, sikurse përcaktohet në kontratë.

3.7 Titullarët e detyrave të projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësura nga Autoritetet Kontraktore si rezultat i gabimeve ose mangësive të projektimit. Në rastin e kontratave që kanë si objekt projektimin ekzekutiv dhe zbatimin e punimeve, kontraktuesi është përgjegjës për vonesat dhe kostot që rrjedhin nga nevoja për të



bërë ndryshime për shkak të mangësive në projektin ekzekutiv.

3.8 Nënkontraktimi pranohet deri në një maksimum prej 30% të vlerës totale të kontratës. Dokumentacioni i tenderit specifikon kushtet e nënkontraktimit. Konkurrentët duhet të deklarojnë në ofertat e tyre, cilat furnizime, shërbime ose punime synojnë të nënkontraktojnë. Ofertuesit depozitojnë kontratat e nënkontraktimit pranë Autoritetit Kontraktor para fillimit të punimeve të nënkontraktimit. Kontraktuesit kryesorë marrin përgjegjësinë e plotë për të gjithë kontratën kundrejt Autoritetit Kontraktor. Nënkontraktuesit duhet të plotësojnë kërkesat në përputhje me paragrafin 1.2 në lidhje me shërbimet që duhet të kryhen dhe që të mos ndeshen me arsyet e përjashtimit të parashtruara në paragrafët 1.6 dhe 1.7. Konkurrenti ose kontraktuesi zëvendësojnë nënkontraktorët që hasen me shkaqe përjashtimi.

3.9 Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen në euro ose në monedhë tjetër të parashikuar shprehimisht nga Marrëveshja. Risqet dhe ndryshimet në kursin e këmbimit nuk do të jenë subjekt i asnjë kompensimi.

3.10 PAGESAT bëhen me metoda të gjurmueshme, sipas afateve të kontratës të cilat marrin parasysh ecurinë efektive të zbatimit. Qeveria italiane i kryen kreditimin Palës tjetër kontraktuese të parashikuar nga marrëveshja në një llogari bankare dedikuar vetëm për zbatimin e marrëveshjes. Në kontrata është e përfshirë një klauzolë që detyron kontraktuesin, dhe nënkontraktuesit për të përdorur për pagesat një llogari bankare të dedikuar.

3.11 Kontrata përfundon me ligj nëse fituesit e kontratës janë subjekt i procedurave të falimentimit, likuidimit të detyrueshëm, administrimit gjyqësor ose marrëveshjes me kreditorët ose gjenden në ndonjë situatë të ngjashme pas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar përkatës.

3.12 Në rast mashtrimi apo faji të rëndë, nuk lejohet kufizimi i përgjegjësisë së kontraktuesve, ose nënkontraktuesve.

3.13 Zbatimi i kontratës rregullohet nga ligji kombëtar i Autoritetit Kontraktor, përveç nëse është parashikuar ndryshe në Marrëveshje dhe në këtë Shtojcë.

3.14. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet fituesve të tenderit dhe Autoritetit Kontraktor nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

3.15 Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e lartpërmendura.

4. KOSTOT E PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME

4.1 Kostot e specifikuara në kontratë janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për realizimin e projektit sipas dokumentit të projektit.

4.2. Në çdo rast, nuk janë të pranueshme kostot që lidhen me ;

4.2.1 Mallrat e panevojshme ose të luksit;

4.2.2 Mallrat, shërbimet dhe punët civile, të lidhura direkt ose indirekt me veprimtarinë ushtarake;

4.2.3 Taksat, tarifat indirekte, duke përfshirë TVSH-në, dhe detyrimet doganore ndaj Shtetit të cilit i përket Autoritetit Kontraktor;

4.2.4 Amortizimi i borxheve të marra më parë dhe humbjet e ardhshme të Autoritetit Kontraktor ose përdoruesve të fundit;

4.2.5 Interesat ndaj të tretëve nga Autoriteti Kontraktor ose nga përdoruesit e fundit.

5. KLAUZOLAT ETIKE

5.1 Çdo përpjekje, nga ana e konkurrentëve (potencialë ose jo) për të marrë informacion konfidencial, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentët e tjerë, ose për të ndikuar Autoritetin Kontraktor në fazat e analizës, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, sjell përjashtimin e konkurrentit nga procedura e tenderit, dhe si rrjedhojë eliminimin e ofertës së tij.

5.2 Personeli që punon në Administratën Publike të Palëve Kontraktuese të Marrëveshjes, pavarësisht nga pozicioni i veçantë administrativ në të cilën ndodhet, nuk mund të punësohet si ekspert ose konsulent nga operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tender.

5.3 Fituesit e tenderit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje në kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk bëjnë deklaratë publike mbi projektin ose shërbimet që kërkohen prej tyre, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor. Në çdo rast, ata nuk angazhojnë në asnjë mënyrë në Autoritetin Kontraktor pa pëlqimin paraprak me shkrim të tij.

5.4 Për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e tenderit respektojnë të drejtat e njeriut dhe marrin përsipër të mos shkelin parimet, zakonet dhe traditat politike, kulturore dhe fetare të Vendit



përfitues. Në veçanti, fituesit e tenderit respektojnë standardet themelore të punës të përcaktuara nga Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në fuqi për Vendin partner dhe për Italinë. Në çdo rast, sigurohet respektimi i dispozitave të “Konventës për lirinë sindikale dhe mbrojtjen e të drejtës sindikale”, të “Konventës mbi të drejtën e organizimit dhe të negocimit kolektiv” të “Konventës mbi punën e detyruar”, të plotësuar me Protokollin e vitit 2014, të “Konventës mbi diskriminimin (punësimin dhe profesionin)”, të “Konventës për format më të këqija të punës së të miturve”, të “Konventës për mbrojtjen e amësisë”, të “Konventës për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi”, të “Konventës Kuadër të Sigurisë në Punë dhe Shëndetësi”.

5.5 Fituesit e tenderit nuk pranojnë pagesa në lidhje me kontratën, përveç atyre të parashikuara në të. Fituesit e tenderit nuk kryejnë asnjë aktivitet dhe as nuk përfitojnë asnjë avantazh nga Autoriteti Kontraktor, që nuk është në përputhje me detyrimet kontraktuale përkatëse.

5.6 Fituesit e tenderit e ruajnë sekretin profesional gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe madje edhe pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të pranuar nga kontraktuesi janë konfidenciale.

5.7 Fituesit e tenderit shmangin çdo marrëdhënie që mund të cenojë pavarësinë e tyre ose atë të personelit të tyre ose ndonjë konflikt tjetër interesash. Nëse fituesit e tenderit ndalojnë së qeni të pavarur ose nëse konfliktet e interesit lindin gjatë zbatimit të kontratës, ata informojnë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Autoriteti Kontraktor mund ta zgjidhë kontratën pa njoftim dhe pa bërë të mundur që fituesi i tenderit të ngrejë pretendime për dëmshpërblim.

5.8 Qeveria italiane rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar financimin e projektit, nëse praktikat e korrupsionit të çdo lloji shfaqen në çdo fazë të procedurës së dhënies së kontratës, dhe nëse Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të marrë të gjitha masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar. Për qëllimet e kësaj klauzole, "praktikat e korrupsionit" janë ofertat e rryshfetit, dhuratat, donacione ose komisione, që konsiderohen si stimul ose shpërblim për cilindo person që ka kryer ose ka abstenuar nga kryerja e çfarëdo veprimi në lidhje me caktimin ose

përmbushjen e një kontrate të lidhur tashmë me Autoritetin Kontraktor.

5.9 Dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përfshijnë një klauzolë që parashikon anullimin e procedurës së tenderit ose zgjidhjen e kontratës të lidhur tashmë, edhe pse në proces ekzekutimi apo tashmë është ekzekutuar, nëse dhënia apo ekzekutimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime tregtare të pazakonta.

“Shpenzimet tregtare të pazakonta” janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore, ose nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur në mënyrë korrekte dhe që i referohen kontratës kryesore, komisionet e paguara jo si rrjedhojë e shërbimeve të ligjshme dhe të kryera realisht, komisionet e paguara në një parajsë fiskale, komisionet e paguara një përfituesi jo qartësisht të identifikueshëm, apo komisionet e paguara për një kompani mbulimi.

5.10 Kontraktuesit, me kërkesë të AICS, ofrojnë elemente provuese për të shpjeguar kushtet në të cilat ekzekutohet kontrata. Autoritetet kompetente të Republikës Italiane mund të kryejnë çdo kontroll, në dokumentacion ose në terren, që e gjykojnë të nevojshme për të mbledhur elemente provuese në rastet e dyshimit për shpenzime tregtare të pazakonta ose praktika të dyshimta të korrupsionit.

5.11. Fituesit e tenderit që kanë bërë shpenzime tregtare të pazakonta në projekte të financuara nga fondet italiane janë subjekt, sipas rëndësisë së fakteve të konstatuara, i zgjidhjes së kontratës ose përjashtimit e përhershëm nga marrja e pagesave me financime nga Qeveria italiane.

5.12 Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave etike nga ana e konkurrentit ose fituesit të tenderit mund të përcaktojë përjashtimin e tij nga kontratat e tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, nga fondet italiane për ndihmë zhvillimore dhe zbatimin e penalteteve të parashikuara në kontratë. Individit ose shoqëria e konsideruar/përgjegjëse duhet të informohet me shkrim për faktin.

5.13. Autoriteti Kontraktor siguron që procedurat për blerjen e të mirave, shërbimeve dhe punimeve do të kryhen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe pavarësisht nga çdo ndikim i jashtëm.

Tiranë
Prot.n.**NOTË VERBALE**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplementat e saj Ambasadës së Italisë në Tiranë. Duke ju referuar Notës Verbale me nr. prot 3083, datë 13 Gusht 2019, si dhe Notës Verbale nr. 6511//0177054, datë 15 Tetor 2019 të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane, referuar Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për *“Programin e rristrukturimit teknik dhe menaxherial të KESH-it dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar”*, lidhur në Tiranë më 13 shkurt 2003, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me autorizim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ka nderin të njoftojë se është dakord me gjitha ndryshimet e propozuara në marrëveshje.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shfrytëzon rastin për t’i shprehur edhe një herë Ambasadës Italiane ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Republika e Shqipërisë
TIRANË

Tiranë
Prot.n.**NOTË VERBALE**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplementat e saj Ambasadës së Italisë në Tiranë. Duke ju referuar Notës Verbale me nr. prot 3083, datë 13 Gusht 2019, si dhe Notës Verbale nr. 6511//0177054, datë 15 Tetor 2019 të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane, referuar Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për *“Programin e rristrukturimit teknik dhe menaxherial të KESH-it dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar”*, lidhur në Tiranë më 13 shkurt 2003, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me autorizim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ka nderin të njoftojë se është dakord me gjitha ndryshimet e propozuara në marrëveshje.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shfrytëzon rastin për t’i shprehur edhe një herë Ambasadës Italiane ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

MINISTRI

Belinda Balluku

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Republika e Shqipërisë

TIRANË





VENDIM
Nr.288, datë 10.4.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE
TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË
NDIHMËS SË MENJËHERSHME
FINANCIARE PËR FOSHNJAT E
PORSALINDURA DHE MËNYRËN E
BASHKËPUNIT, NDËRMJET
INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT
SPITALOR DHE ATYRE
TË GJENDJES CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. MASA E DHËNIES SË NDIHMËS SË
MENJËHERSHME FINANCIARE**

1. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) për prindin/prindërit me foshnja të porsalindura është, si më poshtë vijon:

a) Në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së parë;

b) Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e foshnjës së dytë;

c) Në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së tretë dhe të foshnjave të tjera në vijim;

ç) Për prindërit që sjellin në jetë dy foshnja të lindura njëherësh (binjakë), masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilën foshnjë;

d) Për prindërit që sjellin në jetë më shumë se dy foshnja të lindura njëherësh (trinjakë dhe më shumë), masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilën foshnjë.

2. Në masën e ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfshihet edhe shpërblimi në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për regjistrimin e lindjes brenda afatit, të përcaktuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

**II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E
NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINAN-
CIARE**

1. Ndihmën e menjëhershme financiare (bonusi), sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, e përfitojnë:

a) prindi/prindërit, shtetas shqiptarë për foshnja të lindura brenda ose jashtë vendit dhe të regjistruara sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile;

b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe vendosin t’i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin e Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Nëpunësi i gjendjes civile, i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit on-line të statusit të prindit dhe regjistron foshnjën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010.

Pas regjistrimit kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

3. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi), sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, i jepet prindit/prindërve, menjëherë pas lëshimit të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, në përfundim të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Në rastin kur foshnja ndërron jetë pas lindjes, por për të është plotësuar nga ana e institucionit spitalor dokumenti “Certifikatë asistence në lindje”, prindi/prindërit përfitojnë ndihmën e menjëhershme financiare (bonusin) pasi të kryhet regjistrimi në RKGJC, nga ana e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile dhe të lëshohet dokumenti “Certifikatë nga akti i lindjes” dhe certifikata familjare sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

4. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku, të emetuar në emër të prindit/prindërve, dhe ose sipas rasteve të përcaktuara në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi, dhe të pagueshëm:



a) 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

b) 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

c) 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”;

ç) Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

5. Vlera e përcaktuar në çek tërhiqet në bankat e nivelit të dytë me të cilat Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

III. MËNYRA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton formatin e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, e cila është e njëjtë në të gjitha institucionet e shërbimit spitalor publik dhe miraton formatin e shërbimit spitalor jopublik që ka vendosur vetë institucioni.

2. Institucioni i shërbimit spitalor publik ose jopublik ku ndodh lindja e foshnjës plotëson dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” në dy kopje dhe pajis prindin/prindërit me një kopje të saj. Orari i pajisjes së prindit/prindërve me dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” është nga ora 9:00 deri në 13:00, nga e hëna në të shtunë. Orari i nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile pranë shërbimit spitalor publik ose jopublik është nga ora 09:00-14:00, nga e hëna në të shtunë.

3. Prindi/prindërit e pajisur me dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, të ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor për mbajtjen e “Aktit të lindjes”, çdo ditë, nga e hëna në të shtunë, nga ora 9:00 deri në 13:00. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, në prezencë të prindit/prindërve, administron dokumentin “Certifikatë asistence në lindje”, si dhe mjetin e identifikimit të tyre.

4. Kopja e dytë e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje”, së bashku me fotokopjen e

dokumentit të identitetit të prindit/prindërve i jepet zyrtarisht (dorëzohet) me procesverbal nga personi i autorizuar i institucionit të shërbimit spitalor te nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, i ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor, në përfundim të çdo dite.

5. Për lindjet e ndodhura jashtë institucionit të shërbimit spitalor, si banesë, tren, anije etj. apo në çdo ambient tjetër që nuk është përmendur në këtë vendim personeli që asiston ose verifikon lindjen ka detyrimin të plotësojë dokumentin “Certifikatë asistence në lindje” e të pajisë me një kopje të saj prindin/prindërit dhe kopjen e dytë ta dorëzojë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lindjes së foshnjës në zyrën e gjendjes civile në territorin ku ka ndodhur lindja.

6. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentet e listuara sipas pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, kryen verifikimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, verifikon përbërjen familjare, numrin e foshnjave, dhe pasi bie dakord me prindin/prindërit mbi numrin e pjesëtarëve të familjes, printon certifikatën me gjendje familjare para mbajtjes së aktit të lindjes.

7. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile mban aktin e lindjes, në prezencë të prindit/prindërve, sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim. Pas mbajtjes së aktit të lindjes printon certifikatën nga akti i lindjes, si dhe certifikatën familjare, duke pasqyruar në përbërjen familjare edhe foshnjën.

8. Në rastet kur prindi/prindërit kanë pretendime mbi numrin e anëtarëve të familjes, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile kryen verifikimet e nevojshme deri në zgjidhjen përfundimtare.

9. Certifikatat e plotësuara dhe të lëshuara sipas pikës 8, të këtij kreu, kanë shënimin “Lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Baby Bonus).

10. Prindi/prindërit pasi janë pajisur me certifikatat e sipërpërmendura, paraqiten pranë nëpunësit të autorizuar nga institucioni i shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, për tërheqjen e çekut.

11. Në rastet kur prindi/prindërit nuk mbajnë aktin e lindjes së foshnjës në institucionin e shërbimit spitalor, personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor ia depoziton kopjen e dokumentit “Certifikatë asistence në lindje” nëpunësit të gjendjes civile të atashuar pranë këtij institucioni për verifikimin e pjesëtarëve të



familjes. Nëpunësi i gjendjes civile i atashuar pranë shërbimit spitalor publik/jopublik lëshon certifikatën familjare të prindit/prindërve dhe ia jep nëpunësit të autorizuar të institucionit spitalor, me qëllim përcaktimin e vlerës së çekut. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura bëhen në prani të prindit/prindërve.

12. Për rastet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, çeku lëshohet në emër të prindit/prindërve pasi foshnja regjistrohet si shtetas i Republikës së Shqipërisë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

13. Për foshnjën e lindur në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe të braktisur nga prindi/prindërit, për emetimin e çekut kujdestarit ligjor të fëmijës, merren parasysh afatet për marrjen e kujdestarisë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas verifikimit, nëpunësi i autorizuar i shërbimit spitalor plotëson dy çeqe. Çeku i parë do të jetë në vlerat e përcaktuara në pikën 4, të kreut II, të këtij vendimi.

15. Çeku i dytë do të jetë në masën prej 5 000 (pesë mijë) lekë dhe do të emetohet nga banka pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

16. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor publik ose jopublik, çdo ditë të hënë, bën bilancin e të gjitha dokumenteve “Certifikatë asistence në lindje” të mbajtuara gjatë javës pararendëse dhe të dorëzuara nga institucioni i shërbimit spitalor, sipas pikës 2, të këtij kreu, duke evidentuar ato raste për të cilat është mbajtur akti i lindjes.

17. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, për rastet kur prindi/prindërit refuzojnë të bëjnë regjistrimin e foshnjës së lindur pranë institucionit të shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, i dërgon Zyrës së Gjendjes Civile të vendbanimit të nënës dokumentin “Certifikatë asistence në lindje”, së bashku me dokumentin e identitetit të prindit/prindërve.

18. Nëpunësi i gjendjes civile pranë institucionit të shërbimit spitalor i dërgon informacion me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, çdo ditë të hënë, për dokumentet “Certifikatë asistence në lindje”, të mbajtuara në javën pararendëse dhe të përcjella për veprim të mëtejshëm në zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të nënës.

19. Në rastin kur akti i lindjes nuk mbahet në institucionin e shërbimit spitalor, prindi/prindërit ose njëri nga personat e parashikuar nga ligji i shërbimit të gjendjes civile, për deklarimin e lindjes paraqiten pranë zyrës së gjendjes civile ku kanë vendbanimin. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pas paraqitjes së deklaruesit, kryen veprimet sipas legjislacionit në fuqi dhe pajis me certifikatat e nevojshme deklaruesin.

20. Nëpunësit e zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin prindi/prindërit, të cilit i ka ardhur njoftimi “Certifikatë asistence në lindje”, verifikon fillimisht nëse është regjistruar foshnja e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse foshnja nuk është e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile e regjistron atë në Regjistrin e Përkohshëm.

21. Pas regjistrimit të foshnjës në Regjistrin e Përkohshëm, nëpunësi i gjendjes civile vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjendjen civile.

22. Në rastet kur lindja ka ndodhur në shërbimin spitalor jopublik të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, prindi/prindërit pasi e regjistrojnë foshnjën në zyrën e gjendjes civile, pajisen me certifikatën personale nga akti i lindjes dhe familjare me shënimin:

—“*Lindje në institucion jopublik (emri i institucionit), lëshohet për efekt të përfutimit të ndihmës së menjëhershme financiare*” (Bonusi),

do të paraqiten pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfutuesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;

b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;

c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.

25. Në rastet kur akti i lindjes është mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile pasqyron lindjen në RKGJC, sipas procedurës. Nëpunësi, pasi verifikon nëse lindja është pasqyruar sipas afateve ligjore brenda 90 ditëve pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:

—“*Lindje jashtë shtetit, nr... akti, datë..., muaj..., viti, vendin ku ka ndodhur lindja, lëshohet për efekt të përfutimit të ndihmës së menjëhershme financiare, regjistruar brenda afatit 90-ditor*” (Bonusi),



i cili do të paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfituesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

- a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
- c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.

26. Në rast se deklarimi i aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit kryhet jashtë afatit 90-ditor, nëpunësi i gjendjes civile kryen pasqyrimin e lindjes në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:

– *Lindje jashtë shtetit, nr..akti, datë..., vendim ku ka ndodhur lindja, “Për përfitim të ndihmës së menjëhershme financiare Bonus, regjistruar jashtë afatit 90-ditor, nuk përfiton çekun prej 5 000 pesë mijë lekësh).*

Në këto raste prindi/prindërit nuk përfitojnë pagesën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

27. Për të gjitha rastet që nuk janë parashikuar nga ky vendim veprohet sipas legjislacionit në fuqi.

28. Tërheqja e çekut (Baby Bonus) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës, për foshnjat e lindura brenda ose jashtë shtetit.

29. Të gjitha institucionet e shërbimit spitalor, publike dhe jopublike, që kanë shërbimin e lindjes së foshnjës, duhet të bëjnë me dije dhe të kenë të njoftuar në mënyrë publike se në institucionin e tyre ofrohet edhe shërbimi i gjendjes civile për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të foshnjës së porsalindur.

30. Drejtuesi i shërbimit spitalor, publik dhe jopublik, i licencuar sipas legjislacionit në fuqi, ka detyrimin t’i ofrojë kushte pune dhe një mjedis të përshtatshëm nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, brenda institucionit për kryerjen e detyrave të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

IV. SANKSIONET

1. Zbatimi i përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, është subjekt kontrolli nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Në rast se strukturat përgjegjëse konstatojnë përfitimin pa të drejtë të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), Ministria e Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale merr masa, sipas legjislacionit në fuqi, për kthimin e shumës së përfituar pa të drejtë.

3. Shkelja e përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor, publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) do të jepet sipas përcaktimeve në vendimin nr.740, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”, për të gjithë përfituesit që kanë nisur procedurat për marrjen e këtij përfitimi, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Vendimi nr.740, datë 12.12.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 289, datë 11.4.2020

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË PREFEKTIT TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Çesk Millja, prefekt i Qarkut të Shkodrës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM
Nr. 6, datë 9.4.2020

**PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE
SIPAS NOMENKLATURËS SË
AKTIVITETEVE EKONOMIKE**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 9.4.2020,

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e detajimit të aktiviteteve të përcaktuara në tabelën bashkëlidhur urdhrit nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të cilat detajohen sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike dhe miratohen sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur urdhrit nr.193, datë 20.3.2020, e ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm sipas udhëzimeve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik, për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

3. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM
Nr. 7, date 9.4.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR.254, DATË 27.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS
SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË
SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË
ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË
LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE E TË
PAGESES TË SË ARDHURËS NGA
PAPUNËSIA GJATË PERIUDHËS SË
FATKEQËSISË NATYRORE, TË
SHPALLUR SI PASOJË E COVID-19”**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 9.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin Këshillit të Ministrave për ndryshimin e vendimit nr.254, datë 27.3.2020, me këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 2 dhe 3, të kreut II, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“2. Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vetëpunësuarit/të punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se në një listëpagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrenguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale.

Në rastin kur vetëm një prej aktiviteteve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se në një listëpagesë, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.

3. Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, sipas kategorizimit të mëposhtëm:

a) Personat fizikë të vetëpunësuar;



b) Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;

c) Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;

ç) Të punësuarit në personat juridikë.”.

b) Pas pikës 5, të kreut II, të shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Nuk përfitojnë ndihmë finaciare individët e vetëpunësuar/punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë.”.

c) Në pikën 1, të kreut V, vlera “... 5 850 000 000 (pesë miliardë e tetëqind e pesëdhjetë milionë) lekë ...” të ndryshohet dhe të bëhet “... 6 416 000 000 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTOR
TË EMERGJENCIVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 8, datë 11.4.2020

**PËR CAKTIMIN E TË DELEGUARIT TË
KOMITETIT NDËRMINISTOR TË
EMERGJENCIVE CIVILE, PËR
MENAXHIMIN E FATKEQËSISË
NATYRORE, NË QARKUN
E SHKODRËS**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 11.4.2020,

VENDOSI:

1. Caktimin e z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, me detyrën e të deleguarit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile në Qarkun e Shkodrës.

2. I deleguari i KNEC-së për Qarkun e Shkodrës për çështjet operationale, drejton dhe koordinon, në nivel qendror, strukturat operationale për përballimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore në Qarkun e Shkodrës.

3. I deleguari i KNEC-së, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore, ngarkohet me detyrat e mëposhtme:

a) Të drejtojë dhe të bashkërendojë të gjithë veprimtarinë e institucioneve dhe të strukturave të mbrojtjes civile në Qarkun e Shkodrës;

b) Të përcaktojë mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale në Qarkun e Shkodrës;

c) Të marrë vendime për përballimin e fatkeqësisë natyrore në Qarkun e Shkodrës;

ç) Të kryejë çdo detyrë tjetër që buron nga ligji nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, si dhe detyra të veçanta të caktuara nga KNEC-ja apo strukturat kompetente shtetërore.

4. Të gjitha aktet e nxjerra në zbatim të detyrave, sipas pikës 3, të këtij vendimi, miratohen nga KNEC-ja.

5. I deleguari për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore asistohet nga stafe teknike nga struktura që ai drejton.

6. Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, enteve publike dhe atyre private, të angazhuar në këtë situatë të fatkeqësisë natyrore në Qarkun e Shkodrës, janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e të deleguarit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTOR
TË EMERGJENCIVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë